



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Deliverty | 27-06 | 2 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM/SHCK | 3751/2022 | | 1/1 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.453/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.453/2022 të datës 13.05.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit/Ministria e Financave dhe Transfereve, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.453/2022 e datës 13.05.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. NDRYSHOHET Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 i datës 19.04.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen nga nota 2.8 mirë në notën shume mire 3.5.

III. Ky Vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë si në pikën **II** të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.

IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Transfereve, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Financave sipas Akt emërimit të datës 08.01.2011 në vendin e punës "Zyrtare Ligjore" në Departamentin Ligjor, e pa kënaqur me vlerësimin e punës për vitin 2021, me datë 18.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 843/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 04.04.2022 merr vendimin me numër A.nr.140/2022 me të cilin vendim anulohet vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 26.01.2022 për ankuesen si dhe është obliguar Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Zëvendës Drejtori i Departamentit Ligjor që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor për pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit.

Ministria e Financave dhe Transfereve pas pranimit të Vendimit A.nr.140/2022 të datës 04.04.2022, ka bërë pjesërisht zbatimin e vendimit të Këshillit kështu duke e rivlerësuar ankuesen me notë të përgjithshme 2.8 vetëm për periudhën kohore nga data 01.04.2021 gjer më datën 31.12.2021 ndërsa për periudhën kohore nga data 01.01.2021 gjer më datës 01.04.2021 kur është caktuar udhëheqësi i ri si Zëvendësues i Departamentit Ligjor, ankuesja nuk është vlerësuar për këtë periudhë kohore gjegjësisht për tre (3) muaj të vitit 2021 organi i punësimit nuk ka ofruar dëshmi se ankuesja është rivlerësuar pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.140/2022 të datës 04.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil.

Ankuesja e pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për vitin 2021 me datë 13.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2785/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim kundër vlerësimit të rezultatit të punës për vitin 2021 dhe mos vlerësim të punës për periudhën kohore nga data 01.01.2021 gjer më 01.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 13.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i vlerësimit të rezultatit të punës për vitin 2021 i datës 19.04.2021; Procesverbali i takimit i datës 13.04.2022; e-mail i datës 19.04.2022; Raporti i punës për muajin prill-maj 2021; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2021; Raporti i punës për muajin prill dhe maj 2021; Raporti i punës për muajin Qershor dhe Korrik 2021; Raporti i punës për muajin Gusht dhe Shtator 2021; Raporti i punës për muajin Tetor 2021; Raporti i punës për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2021 sipas delegimit të punëve të pranuar; Akt emërimi i ankueses; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; E-mail-at e datave 03.03.2022, 09.12.2021, 30.09.2021, 30.08.2021, 06.12.2021, 26.11.2021, 19.10.2021, 12.10.2021, 29.10.2021, 25.10.2021; Procesverbali në bazë të vendimit Nr.15/2021 pika 1.2 mbi pranim dorëzimit e dokumenteve origjinale; Prova shtesë të ankesës të datës 18.03.2022; E-mail-at e datave 02.11.2021, 31.10.2021, 29.10.2021, 24.11.2021, Shkresa e datës 05.11.2021 me numër të protokollit 1899-1/2021; përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe njoftimi nga organi i punësimit i datës 20.04.2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses për mos zbatim të vendimit me numër A.Nr.140/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.04.2022 për mos vlerësim të punës për periudhën nga data 01.01.2021 gjer më 01.04.2022 kur edhe është caktuar Zëvendësuesi i ri i Departamentit Ligjor, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i qëndrueshëm sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se rivlerësimi i ankueses është bërë me datë 19.04.2022 vetëm për periudhën kohore nga data 01.04.2021 gjer më 31.12.2021 i cili rivlerësim është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafit 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publikë ku ka përcaktuar se: *"1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë. 5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi",* si dhe neni 8 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ka përcaktuar se *"Mbikëqyrësi, përmes formularit të vlerësimit (Formulari 1) i cili i referohet raportit të vlerësimit si në paragrafin 7 të nenit 43 të Ligjit bënë vlerësimin, notimin e rezultateve në punë të nëpunësit sipas niveleve të vlerësimit të paracaktuara në paragrafin 10 të nenit 43 të Ligjit"*.

Në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka pas parasysh edhe faktin se me datë 20.04.2022 organi i punësimit Ministria e Financave dhe Transfereve e ka njoftuar Këshillin për ndërmarrjen e veprimeve sipas Vendimit me numër A.nr.140/2022 të datës 04.04.2022 dhe se me rastin e njoftimit nuk ka ofruar as një dëshmi se ankuesja është vlerësuar për punën e saj për tërë vitin 2021 rrjedhimisht rivlerësimi i rezultatit të punës për ankuesen është bërë vetëm për periudhën kohore nga data 01.04.2021 gjer më datën 31.12.2021, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe faktet dhe provat konkrete se ankuesja ka arritur objektivat sipas nenit 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)",* vendos t'i ndryshojë notën e vlerësimit të përgjithshme mirë nga 2.8 në notën e përgjithshme shume mire 3.5, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 i të

njëtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.4. nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë"; si dhe 2. . Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: 2.2. "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit".*

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafin 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, është konstatuar se rivlerësimi për rezultatet e punës për vitin 2021 për ankuesen është bërë edhe në kundërshtim me dispozita ligjore të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:.....1.3. është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative".*

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave dhe Transfereve është e obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 e zëvendëson ky vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.453/2022

Valentina Kacandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.